



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK



2011

RAPORT VJETOR


Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2011 deri në 31 Dhjetor 2011.

1. HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2011 deri në 31 Dhjetor 2011.

Gjatë vitit kalendarik 2011 Agjencia e Prokurimit Publik e ka ushtruar veprimtarinë e saj në bazë të ligjit **Nr.9643, datë 20.11.2006** “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për konçesionet”, i ndryshuar, ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” si dhe në bazë të Urdhrave të Kryeministrit nr. 84, datë 10.05.2007 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe **nr.143, date 06.07.2010** “Per miratimin e struktures dhe organikes se Agjencise se Prokurimit Publik”.

Konkretisht, struktura e APP-së është si më poshtë:



2. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA

Gjatë vitit 2011, në kuadër të Programit IPA 2008, Agjencia e Prokurimit Publik ishte përfituese e projektit të binjakëzimit “Mbështetje për forcimin e sistemit Shqiptar për prokurimin publik, koncesioneve dhe ankandit publik”. Përfituesi kryesor i projektit në fjalë është Agjencia e Prokurimit Publik, si institucioni përgjegjës për planifikimin dhe bashkërendimin e ndihmës së huaj për Shqipërinë në fushën e prokurimit publik, dhe partnerë të binjakëzimit është konsortiumi Polako-Rumun.

Qëllimi i këtij projekti, ishte të asistojë në arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian, sikurse janë kërkuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për fushat e lartpërmendura. Projekti filloi aplikimin në muajin Nëntor 2010 dhe do të zgjasë deri në muajin Janar 2012. Gjatë vitit 2011 u ushtrua aktiviteti kryesor i projektit, i cili ka konsistuar në 3 drejtime kryesore dhe konkretisht si më poshtë:

Komponenti i parë “Reforma ligjore dhe institucionale” ka për qëllim kryesisht vlerësimin e kuadrit aktual ligjor dhe institucional të zbatueshëm për kontratat publike, koncesionet dhe ankandin publik, dhe dhënien e rekomandimeve për përjasje të mëtejshme të tyre me direktivat respektive dhe praktikatat më të mira të Bashkimit Evropian.

Komponenti i dytë i projektit “Forcimi institucional për APP-në dhe autoritetet kontraktore në nivel qendror dhe vendor” konsiston kryesisht në hartimin e një plani trajnimi kombëtar, mbështetje për APP në organizmin e seminareve për fushat e sipërcituara, përgatitjen e moduleve të trajnimit dhe manualeve për përdorim gjatë trajnimeve.

Komponenti i tretë “Komunikimi në lidhje me prokurimin publik” ka për qëllim hartimin e një strategjie komunikimi për prokurimin publik, mbështetje për zbatimin e strategjisë, përgatitjen e materialeve informuese për ndërgjegjësim,

mbështetje APP-së për përmirësimin e faqes së saj zyrtare të Internetit, etj.

Aktivitetet e deritanishme të projektit janë realizuar sipas planit të veprimit të hartuar dhe miratuar paraprakisht nga palët, në përmbushjen e të cilëve është angazhuar maksimalisht i gjithë stafi i Agjencisë së Prokurimit Publik. Konkretisht, disa nga aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe të zbatimit të projektit IPA, për komponentin e parë i përkasin vlerësimit të kuadrit aktual ligjor dhe institucional për prokurimin publik dhe koncesionet dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim të mëtejshëm të tyre; hartimi i një plani veprimi për zbatimin e reformës në sistemin e prokurimeve; ekzaminimi i praktikave më të mira të prokurimit në disa prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe krahasimi i tyre me legjislacionin Shqiptar të prokurimit publik; vlerësimi i funksioneve aktuale monitoruese të APP-së; përgatitja e draft-it për amendime në ligjin e prokurimit publik; vlerësimi i dokumentave standarde të tenderit dhe propozime për përmirësim të mëtejshëm të tyre.

Në lidhje me komponentin e dytë, disa nga aktivitetet e kryera në kuadër të projektit të lartpërmendur konsistojnë në hartimin e një Plani Kombëtar Trajnimi në fushën e prokurimit publik; ngritja e 12 Njësive Trajnuese Rajonale në secilën Prefekturë të Qarkut dhe trajnimi i tyre nga ekspertët e projektit dhe stafi i Agjencisë së Prokurimit Publik; hartimi i manualeve dhe udhëzimeve mbi procedurat e rishikimit; organizimi i trajnimeve mbi prokurimin publik me përfaqësues të autoriteteve kontraktore në gjithë vendin, në nivel qendror dhe vendor; përgatitja e moduleve dhe manualeve të trajnimit për përdorim gjatë trajnimeve nga APP.

Aktivitetet e realizuara tashmë në kuadër të aktivitetit të tretë i përkasin hartimit të një Strategjie Komunikimi për prokurimin publik që ka për qëllim arritjen e objektivave të caktuar nëpërmjet mjeteve të komunikimit; përgatitja e materialeve informuese, si broshurë dhe fletëpalosje mbi sistemin e prokurimit publik dhe institucionet e lidhura me të; hartimi i pyetësorëve për autoritetet kontraktore dhe operatorët

ekonomikë dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të Internetit të APP-së, përgjigjet e dhëna gjatë plotësimit të të cilëve do të shërbejnë për adresimin e tematikave të adresuara përkatësisht nga AK-të dhe OE-të. Gjithashtu, vlerësimi i faqes zyrtare të internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe përgatitja e një raporti me propozimet përkatëse për përmirësim të mëtejshëm, është një tjetër aktivitet i realizuar në kuadër të komponentit të tretë të projektit IPA.

Gjatë vitit 2011, APP ka marrë gjithashtu asistencë nga Banka Botërore për përmirësimin e mëtejshëm të sistemi të prokurimit elektronik. Zbatimi i këtij projekti do të shtrihet dhe gjatë vitit 2012.

Një tjetër asistencë e huaj që ka vijuar edhe gjatë vitit 2011 i ka ardhur Agjencisë së Prokurimit Publik në kuadër të ndryshimeve më të fundit në fushën prokurimit në sektorët utilitarë. Në këtë drejtim APP vazhdoi të asistojë edhe gjatë vitit 2011 nga Projekti “Për mbështetjen e Reformës së Prokurimit Publik në Sektorët Utilitarë”, projekt i cili financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Qëllimi i këtij projekti ka qënë forcimi i kapaciteteve administrative mbi zbatimin e legjislacionit të prokurimit për sektorët utilitarë dhe marrëveshjet kuadër.

Në kuadër të tij, gjatë vitit 2011, u përgatit një draft udhëzim për Marrëveshjet Kuadër dhe një draft udhëzim mbi Sistemet e Kualifikimit. Po në këtë kuadër, nga projekti në fjalë, me qëllim ngritjen e kapaciteteve administrative në këto dy drejtime, në muajin Shtator 2011, u organizua një trajnim 2 (dy) ditor, konkretisht në datat 8-9 Shtator. Në trajnim morën pjesë përfaqësues nga APP-ja dhe nga Autoritete të tjera Kontraktore si Organi Qëndror Blerës, Kuvendi i Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit etj. Aktualisht ka përfunduar vlerësimi për funksionalitetet që do të shtohen sistemit të prokurimit elektronik, në kuadër të implementimit të Marrëveshjeve Kuadër dhe Sistemeve të Kualifikimit, proces i cili do të realizohet gjatë vitit 2012.

Gjatë vitit 2011, Agjencia e Prokurimit Publik ka qënë në fokusin edhe të një projekti tjetër të financuar nga BE, me titull “Trajnimi në prokurimin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi”. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është rritja e performancës dhe profesionalizmit në sistemet e prokurimit publik të këtyre vendeve, që përfshin:

1. Zhvillimin e Kurrikulave të Trajnimit për Prokurimin bazuar në Modulet e OECD/SIGMA-s, (të përgatitura sipas Direktivave të BE-së të vitit 2004), për prokurimin), me përshtatjet e nevojshme në kontekstin kombëtar;
2. Një grup bërthamë të certifikuar si Trajnerë Kombëtarë Prokurimi, bazuar në njohuritë e tyre mbi Modulet e SIGMA-s, legjislacionin vendas të prokurimeve dhe aftësive trajnuese.
3. Një rrjet të institucioneve kombëtare trajnuese, të akredituar nga APP-të respektive për të organizuar trajnimet në prokurime për punonjësit e prokurimit, duke përdorur trajnerët e trajnuar nga ky projekt dhe kurrikulat e përgatitura në kuadër të tij.

Gjatë vitit 2011 është implementuar një pjesë e projektit, në kuadër të të cilit janë trajnuar për 5 javë, 5 përfaqësues nga Shqipëria për të qënë trajnerë në prokurimet publike. Zbatimi i projektit do të vijojë dhe gjatë vitit 2012, ku ndër të tjera synohet të trajnohen dhe 15-20 specialistë prokurimi për të qënë trajnerë në këtë fushë sipas standarteve të BE-së. I njëjti numër specialistësh në fushën e prokurimit, është trajnuar dhe do të trajnohet paralelisht në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2011

3.1. Ndryshimet legjislative

Gjatë vitit 2011 nuk ka pasur ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandit publik. Kjo është e lidhur me faktin se në vitin 2010, të gjitha aktet e sipërpërmendura pësuan ndryshime dhe viti

2011, shërbeu si vit për aplikimin e këtyre ndryshimeve në praktikë.

Përveç sa më sipër këtu vlen të përmended se gjatë vitit 2012 ka ndodhur një ndryshim nënligjor, i cili prek drejtëpërsëdrejti prokurimin publik. Konkretisht me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, ndryshohet paragrafi i I-rë dhe i II-të i pikës 2 të udhëzimit në fjalë, duke specifikuar se mbikëqyrësi i punimeve për objekte që ndërtohen me financim publik, përzgjidhen nëpërmjet procesit të prokurimit.

3.2. Iniciativat ligjore në proces

Gjatë këtij viti, me asistencën e projektit të binjakëzimit, të sipërpërmendur, janë hartuar projekt amendimet e ligjit të prokurimit dhe koncesionit, amendime këto të cilat synojnë përafrimin e mëtejshëm me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian. Këto draft amendime, pas konsultimit dhe me palët e interesuara, do të propozohen për miratim gjatë vitit 2012.

3.3. Iniciativat nënligjore të APP-së

Në muajin Janar e në vijim gjatë gjithë vitit 2011, për t’u ardhur sa më shumë në ndihmë autoriteteve kontraktore APP-ja ka hartuar Udhëzimet e detajuara si më poshtë:

- 1- Udhëzimin Nr.1, datë 09.03.2011 për një shtesë në Udhëzimin Nr.2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” me qëllim lehtësimin e procedurave për prokurimet me vlerë të vogël.
- 2- Udhëzimin Nr.2, datë 28.03.2011. Ky udhëzim pasqyron ndryshimet që ka pësuar Vendimi Nr.53, datë 21.01.2009 i Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra

dhe shërbime”. Në mënyrë specifike ky udhëzim ka sqaruar mbi decentralizimin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, të cilat do të kryhen nga vetë autoritetet kontraktore.

- 3- Udhëzimi Nr.3, datë 26.05.2011 “Për kryerjen e procesit të pezullimit në sistemin elektronik të prokurimit”. Me anë të këtij udhëzimi, sqarohen të gjitha autoritetet kontraktore, mbi veprimet teknike që duhet të kryhen në sistem për te realizuar procesin e pezullimit të një procedure prokurimi.
- 4- Udhëzimin Nr.4, datë 22.07.2011. Në respektim të nenit 13/d të ligjit për prokurimin publik, Agjencia e Prokurimit Publik me anë të këtij udhëzimi ka udhëzuar autoritetet kontraktore në lidhje me mënyrën e procedimit, në respektim të Vendimit Nr.472, datë 02.07.2011 “Për disiplinimin e fondeve buxhetore për vitin 2011”.
- 5- Në respektim të nenit 13/d të ligjit për prokurimin publik, Agjencia e Prokurimit Publik me qëllim nxitjen e transparencës në procedurat e prokurimit ka udhëzuar autoritetet kontraktore në lidhje me formatin e njoftimit të fituesit, i cili duhet të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, sipas përcaktimeve të nenit 58 të ligjit për prokurimin publik.

Në këtë kuadër janë nxjerrë Udhëzimet Nr.05, datë 14.10.2011 dhe Nr.6, datë 03.11.2011. Këto udhëzime respektivisht përcaktojnë detyrimin e autoriteteve kontraktore për t’iu referuar formularit të gjate të njoftimit të fituesit, sipas shtojcës së Dokumentave Standarte të Tenderit, për publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike si dhe japin përcaktimin e këtij lloj formati.

3.4.Iniciativat nënligjore në proces

Ndërkohë Agjencia e Prokurimit Publik gjatë tremujorit të fundit të vitit 2011 ka përgatitur dy projekt udhëzime të reja

dhe konkretisht mbi Marrëveshjen Kuadër dhe mbi Mundësinë e Bashkëpunimit të Autoriteteve Kontraktore që kanë nevoja të njëjta për prokurim, udhëzime këto të cilat do të miratohen në fillim të vitit 2012. Gjithashtu nga Drejtoria e IT-së dhe Drejtoria Juridike, janë bërë amendime në dy udhëzime të tjera të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e modifikimit dhe sqarimit mbi dokumentat e tenderit, si dhe me pezullimin e procedurave në sistemin e prokurimit elektronik.

4. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2011

Për realizimin me sukses të detyrave ligjore, në funksion të mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, gjatë vitit 2011, APP-ja është përballur me sfida të ndryshme që kanë kërkuar angazhimin maksimal të saj, nga të cilat më kryesoret kanë qënë angazhimi me Projektin e Binjakëzimit të sipërpërmendur dhe zbatimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të prokurimit elektronik.

Megjithë numrin e vogël të stafit, gjatë vitit 2011, APP-ja është angazhuar maksimalisht për bashkëpunimin me projektin e binjakëzimit, me qëllim arritjen e rezultateve të pritshme prej tij. Për këtë qëllim, punonjësit e APP-së kanë pasur bashkëpunim të ngushtë për realizimin e një numri të konsiderueshëm trajnimesh, dhënien e informacioneve dhe mendimeve për hartimin e raporteve të ndryshme, manualeve, amendimeve të legjislacionit, nga ana e ekspertëve të projektit.

Përsa i përket sfidave të prokurimit elektronik, vlen të përmended krijimi i rolit të administratorit për çdo Autoritet Kontraktor, duke u dhënë secilit prej tyre kompetenca në administrimin e sistemit të prokurimit elektronik dhe roleve të institucionit, për procedurat e veta të prokurimit. Në këtë mënyrë është shmangur komunikimi shkresor ndërmjet APP-së dhe autoriteteve kontraktore, për krijimin apo modifikimin e përdoruesve të sistemit në institucionin e tyre, duke shkurtuar kohën në realizimin e procedurave të prokurimit. Po kështu një sfidë dhe arritje e vitit 2011, është krijimi i arkivës

elektronike në sistem, gjë e cila ka lehtësuar shumë ndërveprimin e autoriteteve në sistem si dhe punën e audituesve të niveleve të ndryshme, si dhe ka rritur nivelin e transparencës në procesin e prokurimit publik. Theksojmë se arkivimi elektronik është në proces përmirësimi për të lehtësuar përdorimin e sistemit. Një tjetër sfidë ishte trajnimi i Autoriteteve Kontraktore për kryerjen e funksioneve të reja që krijohen në sistem.

5. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE.

5.1. Bashkëpunimi i APP-së me institucione homologe të vendeve të rajonit dhe të BE-së

Gjatë vitit 2011, Agjencia e Prokurimit Publik ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me institucione homologe ndërkombëtare. Në këtë kuadër përfaqësues nga Agjencia e Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në disa takime ndërkombëtare, kanë zhvilluar vizita në disa nga vendet e rajonit dhe të BE-së si dhe kanë pritur delegacione me përfaqësues të këtyre vendeve.

Një bashkëpunim shumë të rëndësishëm gjatë këtij viti APP-ja ka pasur me Delegacionin e Komisionit Evropian në Shqipëri. Ky bashkëpunim ka konsistuar në drejtime të ndryshme në fushën e prokurimit, ku një nga drejtimet më kryesore ka qënë puna e përbashkët për implementimin e projektit të binjakëzimit që APP përfitoi nga fondet e IPA-s 2008.

Po në këtë kuadër APP-ja ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me institucionet homologe në Poloni dhe Rumani, me përfaqësues të cilëve janë zhvilluar takime në kuadër të implementimit të projektit të binjakëzimit. Takimet janë realizuar kryesisht në Tiranë, ndërkohë që në muajin Qershor 2011, një grup përfaqësues nga Agjencia e Prokurimit Publik

dhe Komisionit zhvilloi një takim 3 ditor me homologët e tyre në Poloni.

Gjithashtu, po në kuadër të implementimit të projektit të binjakëzimit, një grup përfaqësues nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Komisioni i Prokurimit Publik vizitoi në muajin Nëntor 2011, Agjencinë homologe në Portugali. Në këto vizita, u prezantuan sistemet përkatëse të prokurimit publik, implementimi i praktikave më të mira të Bashkimit Evropian nga vendet anëtare, si dhe u shkëmbyen eksperiencat dhe praktikat më të mira të vendeve respektive. Një rëndësi e veçantë në takimin me homologët portugezë, iu kushtua implemetimit të sistemit të prokurimit elektronik, si dhe zgjidhjeve teknike të secilës prej palëve.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet homologe të vendeve të Ballkanit, në muajin Nëntor 2011, Agjencia e Prokurimit Publik, ftoi një delegacion përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik në Maqedoni. Në këtë takim, përveç diskutimeve mbi zhvillimet më të fundit në sistemet respektive të prokurimit, theksi u vu në sistemin e prokurimit elektronik, që zbatohet nga të dy vendet dhe diskutimi i problematikave të ngjashme. Me rëndësi në këtë takim ishte dhe shpjegimi nga pala maqedonase e zbatimit të ankandit elektronik, dhe përfitimet që vijnë si rezultat i këtij zbatimi, duke qenë ky një objektivi i Agjencisë së Prokurimit Publik në kuadër të shtimit të funksionaliteteve të sistemit elektronik.

Një bashkëpunim tjetër shumë të rëndësishëm gjatë vitit 2011, APP e ka pasur me SIGMA-n (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qendrore dhe Lindore), një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, financuar nga BE.

Një bashkëpunim tjetër me rëndësi, gjatë vitit 2011, APP-ja ka pasur me Bankën Botërore, e cila edhe gjatë këtij viti ka vazhduar të asistojë APP-në, në drejtim të përmirësimit të prokurimit elektronik. Ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2012. Në kuadër të bashkëpunimit të frytshëm me përfaqësuesit e Bankës Botërore, për herë të parë u arrit një

marrëveshje midis palëve, në bazë të së cilës dhe procedurat e prokurimit elektronik që zhvillohen sipas rregullave të Bankës Botërore, të zhvillohen nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka qënë një tjetër organizëm, me të cilin APP-ja ka pasur bashkëpunim shumë të mirë gjatë vitit 2011. Në kuadër të këtij gjatë vitit 2011 ka vijuar implementimi i projektit të sipërpërmendur dhe janë ftuar përfaqësues të APP-së të marrin pjesë në një konferencë ndërkombëtare të organizuar nga BERZH, ku u bë dhe prezantimi i një vlerësimi të sistemeve të rishikimit në prokurime publike, në vendet në tranzicion, ku përfshihet dhe sistemi Shqiptar i prokurimit¹ i cili ka marrë vlerësime pozitive për reformat e implementuara dhe zbatimin e legjislacionit të prokurimit në praktikë.

5.2. Bashkëpunimi i APP-së me institucione të tjera në Shqipëri

Gjatë vitit 2011 Agjencia e Prokurimit Publik ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me institucione të pushtetit qendror dhe vendor brenda vendit. Një bashkëpunim të ngushtë dhe intensiv, APP-ja ka vazhduar të ketë dhe gjatë vitit 2011, me Ministrinë e Integritit. Në mënyrë periodike, në Ministrinë e Integritit është raportuar progresi që ka bërë APP-ja në drejtim të zbatimit të angazhimeve që janë marrë me nënshkrimin e MSA-së në fushën e prokurimeve publike. Me këtë Ministri janë realizuar takime të shpeshta që kanë pasur si objektiv konsultimin e specialistëve me qëllim realizimin e objektivave në fushën e integritit.

Gjithashtu gjatë këtij viti APP-ja ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me Autoritetin e Konkurrencës dhe Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit. Rezultat i këtij bashkëpunimi, ndër të tjera ka qënë dhe publikimi në faqen e internetit të APP-së, i dy dokumentave të punuar nga Autoriteti i Konkurrencës, të cilët lidhen me procesin e

¹ www.ebrd.com/laëintransition

prokurimit dhe konkretisht: “Udhëzim mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, si dhe një broshurë me temë “Sinjalet e një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike”. Po kështu, APP-ja ka publikuar në faqen e internetit të saj një njoftim të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), mbi detyrimin për të respektuar të drejtën e autorit. Kërkesa e ZSHDA për publikimin e këtij njoftimi në faqen e APP-së, vjen si rezultat i numrit shumë të madh të përdoruesve të saj, duke qënë se në të është e vendosur dhe platforma e prokurimit elektronik.

Një tjetër institucion me të cilin APP-ja ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë është dhe Inspektoriati i Lartë Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Midis dy institucioneve janë shkëmbyer informacione dhe është kërkuar asistencë me qëllim luftimin e korrupsionit dhe përfitimit të padrejtë nga shtetas që ndodhen në konflikt interesi.

5.2.1. Bashkëpunimi me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Avokatin e Prokurimeve

Gjatë vitit 2011, Agjencia e Prokurimit Publik, në ushtrimin e detyrave të saj ligjore, ka pasur bashkëpunim me institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik. Në bazë të dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik, KPP-ja ka njoftuar APP-në në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim që ky vendim të pasqyrohet në sistemin e prokurimit elektronik për mosprocedimin e mëtejshëm nga ana e autoriteteve kontraktore. Gjithashtu, ky bashkëpunim evidentohet edhe në rastin e pasqyrit në sistemin e prokurimit elektronik të vendimeve të dhëna nga KPP-ja, në përfundim të shqyrtimit të ankesave. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional, dhe të rolit të saj rregullator në fushën e prokurimit publik, APP-ja ka ftuar Komisionin e Prokurimit Publik në takimet që janë zhvilluar me institucionet homologe në Poloni dhe Protugali, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe përmirësimin e sistemit të rishikimit në prokurime si dhe në trajnimet e organizuara nga Projekti i Binjakëzimit me qëllim ngritjen e

kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit publik dhe koncesionit.

Gjithsesi, duke vlerësuar frymën e bashkëpunimit, theksojmë se në disa nga vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit tejkalon kompetencat që i jep ligji. Kështu p.sh. legjislacioni përcakton APP-në si institucionin kompetent për marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës që kanë kryer shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik dhe të gjitha institucionet kompetente audituese, përfshirë këtu edhe KLSH-në dërgojnë raportet përfundimtare të auditimit në APP. Ndërkohë, praktika e kohëve të fundit ka treguar se, KPP-ja në përfundim të hetimit administrativ të një procedure i është drejtuar direkt AK-së për marrjen e masave administrative, ndonëse nuk është një kompetencë e përcaktuar në ligj, gjë e cila mund të çojë në moskonsiderimin e tyre nga AK-të, mospenalizimin e personave përgjegjës dhe për pasojë mosparandalimin e shkeljes së ligjit të prokurimit publik në të ardhmen nga këta persona. Lidhur me këto çështje, APP-ja ka pasur komunikim të vazhdueshëm me KPP-në, ku i kërkohet respektimi i kompetencave ligjore nga secila prej palëve.

Gjatë vitit 2011, ka vazhduar bashkëpunimi dhe me Avokatin e Prokurimeve. Ky i fundit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, vë në dijeni APP-në për të gjitha hetimet administrative të nisura dhe vendimet e rekomandimet përkatëse, në bazë të të cilave, kur është rasti APP, vendos masa ndaj punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit në Autoritete Kontraktore, ku vërehen shkelje të legjislacionit të prokurimit publik. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional, dhe të rolit të saj rregullator në fushën e prokurimit publik, APP-ja ka ftuar Avokatin e Prokurimeve në trajnimet e organizuara nga Projekti i Binjakëzimit me qëllim ngritjen e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit publik dhe koncesionit.

6. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË DREJTORIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK, GJATË VITIT 2011

6.1. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË DREJTORISË JURIDIKE, MONITORIMIT DHE PUBLIKIMIT

Veprimtaria e Drejtorisë gjatë kësaj periudhe është fokusuar në dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin nga prokurimet publike dhe ankandet të shoqërive të ndryshme etj.

Gjatë vitit 2011 Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit e përqëndroi veprimtarinë e saj në këto drejtime kryesore:

6.1.1 Ndryshimet legislative

Drejtorja Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, gjatë vitit 2011, ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për përmirësimin e legjislacionit dytësor të prokurimit publik dhe nxjerrjen e një sërë udhëzimesh në ndihmë të autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë. Në këtë kuadër, kjo drejtori gjatë vitit 2011 ka luajtur rolin kryesor në përgatitjen e vendimeve dhe udhëzimeve në fushën e prokurimit.

6.1.2. Praktikrat e shqyrtuara për dhënie mendimesh, këshillash apo udhëzimesh

Gjatë këtij viti, Drejtoria Juridike, Monitorimit dhe Publikimit, në zbatim të detyrave që i ngarkon ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për

unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin nga prokurimet publike, koncesioneve apo ankandet të shoqërive të ndryshme, etj.

Asistenca e kësaj drejtorie është përqendruar kryesisht në mirëzbatimin e rregullave të prokurimit dhe këshillimin ligjor për problemet e ndeshura gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Gjatë muajit Gusht e në vijim, kjo drejtori ka trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për sqarim dhe mendim nga autoritetet kontraktore, të cilat kanë konsistuar kryesisht në mënyrën se si duhet të procedohej për procedurat e prokurimit me fonde buxhetore, të nisura në këtë muaj, në kushtet kur u miratua VKM-ja nr.472 date 2.07.2011 ***“Për disiplinimin e përdorimit të Fondeve Buxhetore për vitin 2011”***.

Pas muajit Tetor, kërkesat për sqarim kanë konsistuar edhe në mënyrën se si duhet të procedohej për procedurat e prokurimit me fonde buxhetore, të nisura në këtë muaj, në kushtet kur Rregullat e Prokurimit Publik percaktojnë si afat përfundimtar (përfshirë edhe lidhjen e kontratave) datën 31 Tetor.

Konkretisht numri total i praktikave të paraqitura në këtë drejtori për mendim, sqarim apo informacione nga institucione të ndryshme, gjatë vitit 2011 ka qënë **141**.

Gjithashtu gjatë këtij viti kjo drejtori ka dhënë mendime dhe për projektvendime të ndryshme të iniciuara nga institucione të tjera, të cilat i janë përcjellë për mendim APP-së. Numri total i praktikave për të cilat kjo drejtori ka dhënë mendime për projektvendime të ndryshme, gjatë vitit 2011 ka qënë **20**.

6.1.3. Gjobat dhe masat disiplinore

Një nga kompetencat kryesore të kësaj Drejtorie gjatë vitit 2011, ka qënë dhe shqyrtimi i rekomandimeve të institucioneve audituese, për marrje masash në rast shkeljesh të konstatuara në procedura të ndryshme prokurimi. Në përfundim të hetimeve administrative, raporteve të dërguara nga KLSH, institucionet audituese në vend, apo Avokati i Prokurimeve nga kjo drejtori janë vendosur gjoba, si dhe janë propozuar masa ndëshkuese ndaj personave përgjegjës si më poshtë:

Në 27 praktika janë dënuar me masë administrative Titullarët e Autoriteteve Kontraktore, anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Në 40 praktika janë dënuar me gjobë në vlerë nga 50.000 në 100.000 lekë, Titullarët e Autoriteteve Kontraktore, anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Në 3 praktika u është tërhequr vëmendje Titullarëve të Autoriteteve Kontraktore, anëtarëve të Njesisë së Prokurimit dhe anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

6.1.4. Shqyrtimi i propozimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë

Një kompetencë tjetër ligjore e APP-së, që është ushtruar nëpërmjet kësaj drejtorie gjatë vitit 2011, ka qënë dhe marrja në shqyrtim e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi apo procedura ankandi për një periudhë të caktuar kohore. Konkretisht gjatë vitit 2011 u morën në shqyrtim **32** propozime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, nga të cilat në përfundim të procedimit administrativ **13** (trembëdhjetë) operatorë ekonomikë janë përjashtuar nga e drejta për të marrë pjesë në prokurime. Konkretisht:

6 (gjashtë) nga operatorët ekonomikë të përjashtuar kanë kundërshtuar vendimin e APP-së në gjykatë dhe çështjet janë ende në proces.

Ndërkohë me vendim te ndërmjetëm të Gjykesës së Rrethit Gjyqësor Tirane janë pezulluar zbatimet e akteve administrative të përjashtimit, për **2 (dy)** nga Operatorët Ekonomikë të përjashtuar.

- **2** operatorë ekonomikë nuk janë përjashtuar nga prokurimet publike, pasi dokumentacioni i AK, për propozimet e tyre për përjashtimin nga prokurimet publike të këtyre shoqërive, është konsideruar i pamjaftueshëm apo nuk janë vërtetuar pretendimet e propozuara për përjashtim;

- **1** operator ekonomik nuk është përjashtuar nga ankandi publik pasi dokumentacioni i paraqitur nga autoriteti shitës nuk ka vërtetuar pretendimet e propozuara për përjashtim.

- Për **12** operatorë ekonomikë, i është kërkuar autoritetit kontraktor që të plotësojnë dokumentacionin e paraqitur, pasi, dokumentacioni i paraqitur është gjykuar i pamjaftueshëm për fillimin e procedimit administrativ

- Për **3** operatorë ekonomikë procedimi administrativ për përjashtimin e tyre ka filluar dhe është ende në proces.

7. PUBLIKIMI I BULETINIT TË NJOFTIMEVE PUBLIKE

Në Buletinin e Njoftimeve Publike janë botuar njoftime kontratash për procedurat e shpallura të prokurimit, njoftimet e fituesit, njoftimet e kontratave të nënshkruara, njoftimet e anulimit të procedurave të prokurimit, si dhe njoftime të tjera ku vendin kryesor e zënë njoftimet e administratës publike, si dhe njoftimet për koncesionet dhe ankandet. Gjatë vitit 2011 Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar në total **52** Buletine të Njoftimeve Publike me **13. 005** faqe në total, ose mesatarisht **250** faqe për Buletin.

7.1. Statistika në lidhje me numrin e njoftimeve të procedurave të prokurimit publik të shpallura gjatë vitit 2011

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2010, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, ne faqen zyrtare te APP-së është **4835**, nga të cilët:

Njoftime Kontratash për vitin 2011 të zhvilluara në sistem

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Procudures	Numri i njoftimeve te kontratave	Lloji i Procudures	Numri i njoftimeve te kontratave	Lloji i Procudures	Numri i njoftimeve te kontratave
Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	105	Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
Procedure negocim me shpallje paraprake lokal	2	Procedure negocim me shpallje paraprake		Procedure negocim me shpallje paraprake	
E hapur Nderkombetar	2	E hapur Nderkombetar	3	E hapur Nderkombetar	
Procedure e hapur	352	Procedure e hapur	801	Procedure e hapur	664
Kerkese me Propozim	596	Kerkese me Propozim	1554	Kerkese me Propozim	754
Procedure e kufizuar lokal		Procedure e kufizuar lokal	1	Procedure e kufizuar	
Procedure negocim me shpallje paraprake nderkombetar	1	Procedure negocim me shpallje paraprake nderkombetar		Procedure negocim me shpallje paraprake nderkombetar	
TOTALI	1058	TOTALI	2359	TOTALI	1418

Numri i njoftimeve të fituesit të publikuara është **4217**, nga të cilët:

Njoftime Fituesish për vitin 2011, të zhvilluara në sistem

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te fituesit	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te fituesit	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te fituesit
E hapur Nderkombetar	7	E hapur Nderkombetar	5	E hapur Nderkombetar	
Procedure e hapur	352	Procedure e hapur	1380	Procedure e hapur	522
Kerkese me Propozim	330	Kerkese me Propozim	999	Kerkese me Propozim	561
Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	59	Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
Procedure negociim me shpallje paraprake nderkombetar	1	Procedure negociim me shpallje paraprake nderkombetar		Procedure negociim me shpallje paraprake nderkombetar	
I kufizuar mbi kufirin e larte monetar		I kufizuar mbi kufirin e larte monetar		I kufizuar mbi kufirin e larte monetar	1
TOTALI	749	TOTALI	2384	TOTALI	1084

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara të publikuara është **4105** nga të cilët:

Njoftime Kontratash të nënshkruara për vitin 2011, të zhvilluara në sistem

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te kontratave te nënshkruara	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te kontratave te nënshkruara	Lloji i Procedures	Numri i njoftimeve te kontratave te nënshkruara
Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	59	Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Sherbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
Procedure negociim me shpallje paraprake	1	Procedure negociim me shpallje paraprake		Procedure negociim me shpallje paraprake	
E hapur Nderkombetar		E hapur Nderkombetar	105	E hapur Nderkombetar	
Procedure e hapur	295	Procedure e hapur	1453	Procedure e hapur	483
Kerkese me Propozim	314	Kerkese me Propozim	868	Kerkese me Propozim	526
Procedure e kufizuar		Procedure e kufizuar		Procedure e kufizuar	
E kufizuar Nderkombetar		E kufizuar Nderkombetar		E kufizuar Nderkombetar	1
TOTALI	669	TOTALI	2426	TOTALI	1010

Gjithashtu gjatë këtij viti janë publikuar dhe 1713 Kontrata të nënshkruara për procedura me negociim pa publikim të njoftimit të kontratës.

Në mënyrë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik **të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik** për vitin 2011, dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Nr total i procedurave të shpallura, të ndara sipas llojit të procedurave për Periudhen 1 Janar 2011 - 31 Dhjetor 2011

Nr.Total i Procedurave të shpallura	4835
Fondi total limit i procedurave të shpallura	62,154,425,465
sherbim konsulence nr	105
sherbim konsulence ne vlere	1,187,778,117
negocim me shpallje nderkombetar nr	1
negocim me shpallje nderkombetar vlere	435,178,000
negocim me shpallje lokal nr	2
negocim me shpallje lokal vlere	19,024,666
I hapur nderkombetar nr	5
i hapur nderkombetar ne vlere	4,719,333,515
I hapur lokal nr	1817
I hapur lokal ne vlere	48,445,622,656
kerkese per propozim nr	2904
kerkese per propozim vlere	7,345,238,512
I kufizuar lokal nr	1
I kufizuar lokal vlere	2,250,000

Në mënyrë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, fondin limit përkatës, numrin e procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar përkatës si dhe kursimin në %, të zhvilluara në sistemin elektronik gjatë vitit 2011 janë si më poshtë:

Procedura prokurimi të zhvilluara në sistemin elektronik
- Periudha 1 Janar 2011 - 31 Dhjetor 2011

Nr.Total i Proçedurave te publikuara	4835
Fondi total limit i procedurave te publikuara	62,154,425,465
Nr.Total i Proçedurave te cilat kane vazhduar	3340
Fondi total limit i proc.te cilat kane vazhduar	53,815,679,136
Nr.Total i Proçedurave te paperfundura (anulluar,etj)	1495
Fondi total limit i proc.te paperfundura (anulluar,etj)	8,338,746,330
Nr.Total i Proç.te fituara	4217
Fondi total limit	63,966,553,096
Fondi total i prokuruar	51,097,436,959
% qe ze Fondi i prokuruar ndaj Fondil limit	79.9%
Fondi total i kursyer	12,591,020,524
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	20.1%

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave të zhvilluara në sistemin elektronik janë **3340**, ndërkohë që numri i procedurave të fituara (të cilat maten me njoftimet e fituesve të publikuar në sistem) është **4217**. Diferenca midis numrit të procedurave të fituara me ato të zhvilluara në sistem, shpjegohet me faktin se disa nga këto procedura janë me lote (të ndara në disa nënprocedura) dhe kur shpallet procedura (publikohet njoftimi i kontratës), shpallet si një procedurë e vetme, pavarësisht numrit të loteve që mund të ketë, ndërkohë që kur shpallet fituesi, shpallet për çdo lot më vehte. Kjo është arsyeja që njoftimet e fituesit janë më shumë në numër, se sa njoftimet e kontratave.

Në mënyrë tabelore, të dhënat për prokurimin elektronik dhe procedurat negociim pa shpallje paraprake të njoftimit si dhe raportet në % dhe fondi i kursyer per vitin 2011 janë si më poshtë:

Prokurime elektronike dhe Proc me Negocim pa shpallje paraprake te njoftimit per Periudhen 1 Janar 2011 - 31 Dhjetor 2011

Nr.Total i Proçedurave te publikuara elektronike	4835
Fondi total limit i procedurave te publikuara elektronike	62,154,425,465
Nr.Total i Proç.te fituara elektronike	4217
Fondi total limit i procedurave elektronike	63,966,553,096
Fondi total i prokuruar i procedurave elektronike	51,097,436,959
Nr.Total i Proç.te fituara Negoc pa shpallje	1,713
Fondi total limit i prokuruar negoc pa shpallje	6,068,755,518
Fondi total i ofruar negoc pa shpallje	5,903,078,523
% qe ze nr I proc te fituara negoc me shpallje ndaj nr total te procedurave te fituara në total (elektronik+negocim pa shpallje)	28.9 %
% qe ze fondi limit I proced me negoc pa shpallje ndaj fondit limit total (elektronik + negociim pa shpallje) per procedurat e fituara	8.7 %
% qe ze fondi I ofruar proced me negoc pa shpallje ndaj fondit total (elektronik + negociim pa shpallje) per procedurat e fituara	10.4 %
Nr.Total i Proç.te fituara (elektronik + negociim pa shpallje)	5,930
Fondi total limit i prokuruar (elektronik + negociim pa shpallje)	70,035,308,614
Fondi total i ofruar (elektronik + negociim pa shpallje)	57,000,515,482
% qe ze Fondi i ofruar ndaj Fondil limit te prokuruar	81.4 %
Fondi total i kursyer	13,034,793,132
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondil limit te prokuruar	18.6 %

Në mënyrë tabelore, për procedurat e prokurimit elektronik të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2011 janë si më poshtë:

Llojet e procedurave	Nr.Total i procedurave	Fondi limit total i prokuruar	Fondi total i ofruar(tenderuar)	% qe ze Fondi i ofruar ndaj Fondil limit te prokuruar	Fondi total i kursyer	% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondil limit te prokuruar
Procedure e hapur nderkombetare (njoftim fituesi)	12	3,416,729,409	3,341,470,830	97.8%	75,258,579	2.2%
Procedure e hapur (njoftim fituesi)	2254	38,954,300,831	33,960,867,380	87.2%	4,993,433,450	12.8%
Kerkese per propozim (njoftim fituesi)	1890	4,637,695,066	4,026,788,153	86.8%	610,906,913	13.2%
Sherbim konsulence, konkurs projektimi (njoftim fituesi)	59	1,105,670,205	1,002,665,104	90.7%	103,005,101	9.3%
I kufizuar mbi kufirin e larte monetar	1	15,416,979,585	8,334,905,605	54.1%	7,082,073,980	45.9%
Procedure negociim me shpallje paraprake nderkombetar	1	435,178,000	430,739,886	99.0%	4,438,114	1.0%
Totali	4217	63,966,553,096	51,097,436,959	79.9%	12,869,116,137	20.1%

8. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2011, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ka bërë përmirësime të ndjeshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit, sidomos në Sistemin e Prokurimit Elektronik në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale të Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri. Detyrat kryesore të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit kanë qenë:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit duke siguruar kushte sa më të mira pune për të gjithë përdoruesit online të sistemit të prokurimit elektronik.

- Rritja e kapaciteteve hardware veçanërisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik duke u mundësuar të gjithë përdoruesve një ambient stabil dhe të sigurtë pune. Këtu mund të përmendim blerjen dhe instalimin e serverave të arkivës elektronike, në mënyrë që të realizohej transferimi i procedurave të cilat kishin më shumë se 1 vit online, nga databaza operacionale, drejt asaj arkivë. Në këtë mënyrë u realizua ndarja e arkivës nga baza e të dhënave operacionale si dhe optimizimi i kësaj të fundit. Nxjerrja online e arkivës elektronike të sistemit të prokurimit elektronik për rolin “Auditor” solli një lehtësim dhe transparencë më të madhe. Tashmë çdo procedurë mund të auditohet në mënyrë të plotë, në kohë reale.

- Zhvillimi i funksionaliteteve të sistemit për përmirësimin e pikave ku shfaqeshin pengesa brenda bazës së të dhënave, të cilat sillnin vonesa në punën e përdoruesve të sistemit të prokurimit elektronik.

- Kryerja e investimeve në ambientin fizik të dhomës së serverave si dhe blerja e pajisjeve të ndryshme si sistem për mbrojtjen kundra zjarrit, kondicioner etj, për rritjen e sigurisë.

- Bashkëpunim me institucionet si Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik për përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen kapaciteteve. Ky bashkëpunim ka rezultuar i suksesshëm në ofrimin e sigurisë për sistemin e prokurimit

elektronik, për projektligjin “Arkivimi elektronik dhe bazat e të dhënave shtetërore”, për iniciativën e implementimit të Nënshkrimit Elektronik, etj

- Përmirësimi i faqes zyrtare të internetit të APP-së, e cila është pasuruar me informacion të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit.

- ⇒ Publikimi i buletinit javor;
- ⇒ Publikimi i legjislacionit të përditësuar, vendimeve dhe udhezimeve
- ⇒ Publikimi i njoftimeve të ndryshme dhe manualeve të përdorimit të sistemit;
- ⇒ Rimodelim i rubrikave të ndryshme si “Koncesione”, “Raporte dhe Monitorime”, “Manualet e Prokurimit”, “Trajnime” në gjuhën Shqipe dhe në gjuhën Angleze;

Disa nga pikat kyçe të cilave u është kushtuar një rëndësi e veçantë dhe e përherëshme, janë:

- ⇒ Përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së Sistemit të Prokurimit Elektronik;
- ⇒ Monitorimi i performancës së “Internet Information Server – IIS”;
- ⇒ Monitorimi i performancës së komponenteve hardware të serverave;
- ⇒ Monitorimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave.

Gjithashtu, nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, janë monitoruar vazhdimisht edhe skedarët log të Bazës së të Dhënave, Sistemit të Operimit, Internet Information Server – IIS, Cisco Firewall dhe të Enterprise Virtual Array ose EVA Controller.

Nuk duhet harruar pa përmendur fakti që mbajtja online e sistemit të prokurimit elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës,

është një sfidë e madhe me të cilën përballlet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit.

Qëndrimi në gadishmëri jashtë orarit zyrtar të punës, gjatë fundjavës dhe ditëve të cilat janë festa zyrtare i specialistëve të kësaj drejtorie, duke monitoruar ecurinë e punës në sistem dhe duke u siguruar për kushtet fizike në të cilat ndodhet dhoma e serverave, ka qenë një detyrë impenjative e kësaj drejtorie (rreth 104 ditë qëndrimi në gadishmëri ose 8760 orë në vit). Gjithashtu, specialistët e kësaj drejtorie kanë qëndruar stand-by në ditët kur janë bërë përmirësime software dhe hardware në dhomën e serverave (rreth 580 orë në vit).

8.1. Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP-së

Mbështetja teknike që u jepet të gjithë operatorëve ekonomikë të huaj dhe vendas si dhe të gjitha autoriteteve kontraktore që përdorin sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet komunikimit me e-mail, telefonit apo dhe konsultimeve në ambjentet e APP, është një punë e përditshme për këtë drejtori. Këtu vlen të përmendet se numri i telefonatave ka qenë rreth 45 telefonata në ditë.

Po në kuadër të asistencës teknike në drejtim të përdoruesve të sistemit të prokurimit elektronik, gjatë vitit 2011 kjo drejtori ka hartuar 520 shkresave në total. Këtu përfshihen:

- ⇒ Krijim llogarie në rolin CA Admin dhe Operator Ekonomik, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjendje fillestare;
- ⇒ Shkresa sqaruese për Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë;
- ⇒ Shkresa për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera;

- ⇒ Memo të brendshme dhe memo për bashkëpunim me drejtoritë e tjera brenda APP;

Përveç komunikimit shkresor, gjatë vitit 2011 në kuadër të asistencës teknike, kjo drejtori ka pasur dhe një komunikim intensiv nëpërmjet postës elektronike (e-mail). Gjatë këtij viti nga specialistët e drejtorisë janë dërguar përafërsisht 1435 e-mail-eve në total:

- ⇒ drejt operatorëve ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjendjen fillestare, për sqarime, instruksione dhe ankesa);
- ⇒ drejt autoriteteve kontraktore (për sqarime dhe instruksione);
- ⇒ drejt institucioneve të tjera (për dërgim të dhënash dhe informacionesh);

Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit IPA 2008 AL 08 IB EC 01 “Mbështetje për Forcimin e Sistemit Shqiptar të Prokurimit Publik, Koncesioneve dhe Ankandit Publik”, Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit ka qenë aktive në trajnimin e autoriteteve kontraktore, si në Tiranë ashtu edhe nëpër rrethe, për ndryshimet dhe përmirësimet e reja në sistemin e prokurimit elektronik;

Gjatë vitit 2011 Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit ka punuar intensivisht për krijimin dhe përmirësimin e manualeve dhe udhëzimeve për përdoruesit e sistemit të prokurimit elektronik, ku risi janë:

- ⇒ Udhëzimi “Për sqarime dhe modifikime në dokumentet e tenderit shoqëruar me shtyrjen e afatit në sistemin e prokurimit elektronik”.

- ⇒ Manuali i ri për rolin “Auditor” ku përfshihet edhe auditimi i procedurave të arkivuara.
- ⇒ Përditësimi i të gjitha manualeve të tjera duke ndjekur çdo fazë të procedurës për të gjithë rolet e përdoruesve të sistemin e prokurimit elektronik.

Nuk duhet harruar pa u përmendur edhe puna e përditshme e Drejtorisë së IT në suportin e vetë përdoruesve brenda APP-së si dhe në menaxhimin e infrastrukturës. Kryerja e detyrave të ngarkuara (si kryerja e backup-eve, monitorime komponentesh hardware, monitorim komponentesh software, etj) ka sjellë rezultate shumë të mira,

Bashkëpunimi i Drejtorisë së IT me Drejtorinë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit ka qënë shumë produktiv për sa i përket evidentimit të rasteve problematike dhe zgjidhjen e tyre si dhe në përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.

8.2. Përmirësimet e bëra në sistemin e prokurimit elektronik si dhe hyrja në sistem nga të interesuarit

Gjatë vitit 2011 nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit janë bërë përmirësime të dukshme mbi sistemin e prokurimit. Në këtë kontekst, kjo drejtori, ka arkivuar elektronikisht përafërsisht 28,235 procedura të realizuara në vitin 2008, 2009 deri në fillim 2010. Këto procedura ruhen në një server tjetër “Arkivë” me qëllim lehtësimin e bazës së të dhënave operacionale dhe cilësi më të lartë të shërbimit, si dhe rritje të shpejtësisë së gjetjes së të dhënave dhe efikasitetit në procedurat elektronike në sistemin e prokurimit publik. Në muajin Dhjetor 2011 kjo arkivë elektronike doli online, dhe tashmë është i mundur edhe auditimi i procedurave të

arkivuara. Por gjatë kohës që kjo arkivë nuk ka qenë në dispozicion të përdoruesve, Drejtoria IT ka kryer teknikisht në arkivë nxjerrjen e 101 procedurave dhe dërgimin me CD/DVD të materialit elektronik të nxjerrë për këto procedura drejt autoriteteve kërkuese.


Nga llogaria “Administrator” i autoriteteve kontraktore në sistem, janë krijuar 2835 llogari përdoruesi (anëtarë të Njesisë së Prokurimit, të Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave, të Komisionit të Shyrtimit të Ankesave dhe atë të Auditit, për autoritetet kontraktore në sistem.

Për vitin 2011, në sistemin e prokurimit elektronik, janë regjistruar 347 operatorë ekonomikë të rinj nga të cilët 119 janë operatorë ekonomikë të huaj. Përqindja e konsiderueshme e numrit të operatorëve të huaj të regjistruar në sistem gjatë vitit 2011, krahasuar me operatorët shqiptar të regjistruar po gjatë këtij viti, tregon nivelin e lartë të besueshmërisë që ka krijuar ky sistem jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij.

Gjithashtu kjo shifër shpjegohet dhe me lehtësinë e ndërveprimit që ofrohet nga ky sistem për të ofertuar në procedurat e prokurimit publik edhe nga jashtë vendit.


Më poshtë jepet një paraqitje grafike e numrit të operatorëve ekonomikë të regjistruar në sistem gjatë vitit 2011.

**Operatorët Ekonomikë të regjistruar në vitin
2011**



Ndër operatorët ekonomikë të huaj, të regjistruar gjatë vitit 2011, një numër shumë i madh i tyre vjen nga kontinenti i Europës nga vende si Italia, Greqia, Anglia, Austria, Kosova, Franca, Gjermania, Spanja, etj. Grafikisht kjo shpërndarje pasqyrohet si më poshtë:

**Shpërndarja e operatorëve ekonomikë të
huaj**




Aktualisht numri total i operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj, të regjistruar në sistemin e prokurimit elektronik është 109 369.

Më poshtë tregohen disa statistika të përgjithshme mbi përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik në vitin 2011:


Statistika të Përgjithshme

Klikimet në total:	87,398,644
Mesatarja e klikimeve për ditë	239,448
Përdoruesit në total	249,880
Mesatarja e përdoruesve për ditë	685
Sesionet në total:	484,502
Mesatarja e sesioneve për ditë:	1,327
Koha totale e shpenzuar në faqe nga përdoruesit:	5477 Ditë, 05h e 08min e 16s


Sesionet për muaj




Hits-et totale për muaj



Përdorimi sipas ditëve të javës




Përdorimi sipas orëve të ditës




Numri total i ofertave në sistemin e prokurimit elektronik, gjatë vitit 2011 ka qënë 27.446. Numri mesatar i ofertave të paraqitura në një procedurë është 6.

Në diagramën e mëposhtme pasqyrohen procedurat e prokurimit, njoftimet e fituesve dhe njoftimet e kontratave të nënshkruara të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik, gjatë vitit 2011.




Në diagramën e mëposhtme pasqyrohen procedurat e prokurimit, të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik, gjatë vitit 2011, krahasuar me vitin 2010:

Numri i procedurave të shpallura në SPE



Në diagramën e mëposhtme pasqyrohen njoftimet e fituesit të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik, gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010:



9. TREGUESIT E VEPRIMTARISË NË DREJTIM TË INTEGRIMIT, MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS

Duke pasur parasysh:

- ⇒ Rëndësinë që kanë marrëdhëniet me publikun, sidomos për prokurimet publike në kuadër të transparencës;
- ⇒ Rëndësinë e madhe që kanë trajnimet për prokurimet publike, ku APP është institucioni përgjegjës për organizimin e seminareve dhe trajnimeve në fushën e prokurimit;
- ⇒ si dhe detyrimin e përafritimit të legjislacionit me Direktivat e BE-së dhe zgjidhjen dhe mbulimin e problemeve që dalin në kuadrin e integritimit evropian,

edhe puna në drejtim të menaxhimit të çështjeve të integritimit, burimeve njerëzore, dhe financës, ka zënë një pjesë të rëndësishme në aktivitetin e APP-së gjatë vitit 2011.

9.1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Edhe gjatë vitit 2011, nisur dhe nga ndryshimet e numrit të punonjësve dhe strukturës së saj, Agjencia e Prokurimit Publik, e ka ushtruar aktivitetin e saj ligjor me dy Drejtori kryesore; Drejtorinë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit. Për shkak të rëndësisë dhe shtrirjes së aplikimit të sistemit të prokurimit elektronik, drejtoria e IT vazhdon të jetë edhe aktualisht drejtoria më e madhe në numër. Në kuadër të ndryshimeve të strukturës së Agjencisë në vitin 2010 u nxorën në listë pritje 8 punonjës nga të cilët 3 janë shkëputur nga lista e pritjes për shkak të rifillimit të marrëdhënieve të punës në administratën publike, 3 kanë përfunduar efektin e listës së pritjes në muajin Maj të vitit 2011 për shkak të plotësimit të afatit 1-vjeçar të qëndrimit në listë-pritje dhe 2 të tjerë do të vazhdojnë të jenë në listë- pritje deri në muajin Janar 2012.

Autoriteti Përgjegjës në institucion, ka mbajtur në mënyrë të rregullt kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe ka raportuar emrat e personave përgjegjës për deklarimin e pasurive në institucion, si dhe ka dërguar në kohë Deklarimet përkatëse.

9.2. Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP-së dhe specialistëve të prokurimit pranë autoriteteve kontraktore

9.2.1. Trajnimet e stafit të APP-së

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve administrative, gjatë vitit 2011 përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik kanë marrë gjithashtu pjesë në një sërë seminaresh të organizuar brenda dhe jashtë vendit dhe konkretisht si më poshtë:

11 Prill- 15 Korrik 2011, 2 përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në një trajnim për trajnerë në prokurimin publik. Ky trajnim i cili zgjati 5 javë, ishte i bazuar në Modulet e zhvilluara nga SIGMA, bazuar në Direktivat e Bashkimit Evropian për prokurimin publik. Trajnimi u organizua në ambientet e Kampusit të ITCILO, në Torino, Itali dhe përbën fazën e parë të projektit “Trajnim për trajnerë në prokurimin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi”, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Në kuadër të projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për forcimin e sistemit Shqiptar për prokurimin publik, koncesioneve dhe ankandit publik”, të Programit IPA 2008, janë organizuar një sërë aktivitetesh trajnuese me përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik, Komisionit të Prokurimit Publik dhe Avokatit të Prokurimeve.

Konkretisht, në datën 28 Janar 2011, nga ekspertët e projektit të sipërpërmendur u zhvillua një trajnim me stafin e APP-së, me temë “Trajnim për Menaxhimin e Ciklit të Binjakëzimit për Personelin e Agjencisë së Prokurimit Publik”. Në këtë trajnim morën pjesë 8 persona.

Në datën 7 Prill 2011 u zhvillua një trajnim me përfaqësues nga APP-ja, KPP-ja dhe AvP, me temën “Koncesionet, dialogu konkurrues dhe partneritetet në prokurimet publike”. Në këtë trajnim morën pjesë 10 persona.

Në datën 21 Prill 2011, u organizua një trajnim një ditor me përfaqësuesit e lartpërmendur mbi “Marrëveshjen kuadër, nënkontraktimi dhe rastet e fundit në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, praktika gjyqësore për prokurimin publik”. Në këtë trajnim morën pjesë 9 persona.

Në datën 4 Maj 2011, trajnimi i radhës pati si synim temën “Shqyrtimi i masave dhe procedurave në dritën e kërkesave të BE-së”. Në këtë trajnim morën pjesë 10 persona.

9.2.2. Trajnimet e punonjësve të prokurimit pranë autoriteteve kontraktore

Siç është përmendur dhe në fillim të kësaj analize, një nga fokuset e Projektit të Binjakëzimit që asistoi APP në gjatë vitit 2011, ka qënë trajnimi në bashkëpunim me këtë të fundit, i punonjësve të prokurimit pranë Autoriteteve Kontraktore. Në këtë kuadër, gjatë këtij viti janë organizuar një numër i konsiderueshëm trajnimesh në Tiranë dhe në rrethe dhe konkretisht:

Në datat 20-22 Qershor, 2011 u zhvillua një trajnim 3 -ditor me temë “Trajnim për trajnerë në prokurimin publik” me nga 3 përfaqësues nga 12 Prefekturat e vendit. Ky trajnim kishte për qëllim krijimin e bërthamave trajnuese për prokurimin publik në secilën prej 12 Prefekturave. APP synon trajnimin e vazhdueshëm të këtyre bërthamave, me qëllim shfrytëzimin e tyre për transferimin e njohurive tek Autoritetet Kontraktore që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në nivel lokal. Në këtë trajnim, morën pjesë 33, 35 dhe 34 persona respektivisht për çdo ditë.

Në datën 7 Korrik 2011, u zhvillua një trajnim me përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit me temë mbi “Koncesionet,

Marrëveshja Kuadër, Kriteret e Perzgjedhjes së Kontrates dhe Prokurimi Elektronik”. Në këtë trajnim morën pjesë 19 persona.

Në datën 14 shtator 2011, u zhvillua në qytetin e Vlorës një trajnim një ditor me temë “Procesi i Planifikimit Publik, Marrëveshja Kuadër, Kriteret e Përzgjedhjes së Kontratës dhe Prokurimi Elektronik”, me përfaqësues të pushtetit vendor dhe qëndror të Qarkut të Vlorës. Në këtë trajnim morën pjesë 28 persona.

Në datën 29 shtator, 2011 u zhvillua një trajnim një ditor mbi “Luftën kundër korrupsionit në prokurimet publike”, me përfaqësues nga Departamenti i Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave, Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Avokati i Prokurimeve, Komisioni i Prokurimit Publik, Autoriteti i Konkurrencës dhe me nga një përfaqësues nga 12 prefekturat e vendit. Në këtë trajnim morën pjesë 16 persona.

Trajnimi i radhës u organizua në qarkun e Shkodrës në datat 4-6 Tetor 2011 me përfaqësues të pushtetit vendor dhe qëndror nga ky qark. Në këtë trajnim morën pjesë 35, 26 dhe 25 persona, respektivisht për çdo ditë.

Në datat 20 dhe 21 Tetor u zhvilluan 2 trajnime një ditore në Qarkun e Beratit me institucionet vendore dhe qëndrore në këtë qark. Në këto trajnime morën pjesë 27 dhe 17 persona, respektivisht për çdo ditë.

Në datën 09 Nëntor, 2011 trajnimi u organizua në Pogradec me përfaqësues të prokurimeve publike nga institucionet vendore dhe qëndrore nga qyteti i Pogradecit, Korçës dhe Librazhdit. Në këtë trajnim morën pjesë 39 persona.

Në datën 01 Dhjetor, 2011 u realizua një trajnim një ditor mbi procesin e planifikimit të prokurimeve publike, marrëveshja kuadër dhe kriteret e dhënies së kontratave dhe prokurimi elektronik me përfaqësues nga ministritë dhe nga pushteti Qendror, në Tiranë. Në trajnim morën pjesë 35 persona.

Këto trajnime kanë pasur për qëllim përmirësimin e njohurive të pjesëmarrësve me tematikat kryesore të prokurimit publik dhe koncesioneve, si dhe njohjen e tyre me parashikimet respektive të BE-së.

Këto trajnime u realizuan në bashkëpunim nga punonjësit e APP-së dhe ekspertët e projektit në fjalë. Numri total i personave të trajnuar gjatë vitit 2011 si rezultat i këtij bashkëpunimi, ka qënë **406 persona**.

9.3. Integrimi

Në kuadër të procesit të Integritimit Evropian, një detyrë e rëndësishme e Agjencisë së Prokurimit Publik në këtë drejtim, gjatë vitit 2011, ka qënë raportimi periodik pranë Ministrisë së Integritimit dhe Strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri, të krijuara me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA). Këto raportime kanë pasur në fokus progresin e arritur në fushën e prokurimit publik, si dhe përmbajnë një përshkrim të prioriteteve të fushës, për periudhën në vazhdim.

Gjatë këtij viti, raportimet me shkrim janë realizuar në nivel kapitulli, një praktikë e ndjekur gjatë përgjigjeve të pyetjeve të Pyetësorit të Komisionit Evropian, për Shqipërinë. Agjencia e Prokurimit Publik, si institucion koordinues për kapitullin 5 “Prokurimi Publik”, jo vetëm ka përgatitur informacionin e kërkuar në përmbushje të detyrimeve të saj, por gjithashtu ka unifikuar dhe koordinuar gjithë materialin e përgatitur dhe dërguar pranë saj nga institucionet e tjera kontribuese të kapitullit për fushën e prokurimit publik. Raportimi në nivel kapitulli është përqëndruar kryesisht në përmirësimet në kuadër të reformës legislative, implementimit të legjislacionit, si dhe të kuadrit institucional.

Ndërkohë, përveç raportimeve të lartpërmendura, përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik gjatë këtij viti kanë marrë pjesë në takimet dy palëshe BE-Shqipëri, të zhvilluara në Bruksel. Gjatë këtyre takimeve, është raportuar mbi zhvillimet më të fundit mbi detyrimet e marra me Marrëveshjen e

Stabilizim Asociimit për fushën e prokurimit publik, kryesisht ato legislative dhe institucionale.

Gjithashtu, një detyrim tjetër që rrjedh nga MSA, në kuadër të procesit të Integritimit Evropian, është edhe përkthimi i legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe dhe përkthimi i legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian. Gjatë kësaj periudhe, APP është angazhuar në këtë proces, ku në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit, kanë kontribuar në përkthimin e tre direktivave të BE-së në fushën e prokurimit publik, në gjuhën shqipe. Ky është një bashkëpunim, i cili do të vazhdojë edhe në të ardhmen me përkthimin në gjuhën shqipe të akteve të tjera Evropiane në këtë fushë, dhe anasjelltas.

Dhënia e asistencës në arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian për fushën e prokurimit publik, sikurse janë kërkuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ka qënë qëllimi i zbatimit të projektit të Binjakëzimit IPA 2008 “Mbështetje për forcimin e sistemit Shqiptar për prokurimin publik, koncesioneve dhe ankandit publik”, sikurse është përmendur që në fillim të kësaj analize.

9.3.1. Përfaqësimi i stafit të APP-së në takime dhe forume ndërkombëtare

Gjatë vitit 2011, punonjës të Agjencisë së Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në disa takime ndërkombëtare mbi çështjet e prokurimit publik, të cilat kishin për qëllim prezantimin e pjesëmarrësve me zhvillimet më të fundit rregullatore të Bashkimit Evropian në këtë fushë dhe shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet vendeve pjesëmarrëse.

Në muajin Mars 2011, 3 (tre) përfaqësues të APP-së morën pjesë në Konferencën e Pestë Rajonale për Prokurimin Publik, të organizuar nga OECD/SIGMA në Stamboll, Turqi. Në fokus të kësaj Konference ishte paraqitja e reformave më të fundit të ndërmarra në sistemet kombëtare të prokurimit publik dhe përqëndrimi i prioriteteve në vazhdim.

Mbështetur në ftesën e Auftrag.at (Country Based Directory of Public Tenders – Drejtoria Bazë Shtetërore për Tenderat Publik) me qendër në Vienë, Austri, 2 përfaqësues të APP-së morën pjesë në një takim që kishte në fokusin e tij pranimin dhe progresin e Prokurimit Elektronik. Ky takim u zhvillua në Vienë, në datën 24 Mars 2011. Përfaqësuesit e APP-së mbajtën një prezantim mbi sistemin e prokurimit elektronik, sfidat dhe arritjet në Shqipëri.

Në muajin Maj 2011, 2 (dy) punonjës të Agjencisë së Prokurimit Publik ishin pjesëmarrës në Konferencën e organizuar nga OECD/DAC, për prokurimin publik, të zhvilluar në Kusko, Peru, qëllimi i të cilës ishte shkembimi i eksperiencave në këtë fushë ndërmjet shteteve pjesëmarrëse.

Gjithashtu, po në muajin Maj 2011, 2 (dy) përfaqësues të APP-së morën pjesë në Forumin e Shtatë Rajonal të Prokurimit Publik, të organizuar në Tbilisi, Gjeorgji, nga Banka Aziatike për Zhvillim, Banka Islamike për Zhvillim, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe Banka Botërore. Objektivi kryesor i këtij takimi ishte prezantimi i reformave kryesore të vendeve në Forum, në drejtim të zbatimit efektiv të ligjeve, akteve nënligjore dhe praktikave më të mira të prokurimit publik.

Në muajin Qershor 2011, APP u përfaqësua me 1 (një) pjesëmarrës në Konferencën e parë rajonale për Evropën Juglindore mbi menaxhimin e blerjeve dhe furnizimit “Një Përfaqëse Strategjike për Menaxhimin e Prokurimeve dhe Furnizimit”, që u zhvillua nga Sekretariati i Institutit Grek të Blerjeve në Selanik, Greqi. Ndërkohë, po në muajin Qershor 2011, mbështetur në ftesën e dërguar nga Komisioni Evropian, 1 (një) përfaqësues i Agjencisë së Prokurimit Publik mori pjesë në Konferencën Evropiane për prokurimin publik “Përballimi i sfidave shoqërore, ofrimi i shërbimeve më të mira publike dhe mbështetja për biznesin e vogël dhe të mesëm”, të zhvilluar në Torino, Itali.

Në muajin Shtator 2011, 2 (dy) përfaqësues të APP-së morën pjesë në Konferencën për Prokurimin Publik, të organizuar

nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në Shën Petërburg, Rusi. Në këtë Konferencë u prezantuan zhvillimet më të fundit në politikat e prokurimit publik, si dhe u diskutua mbi axhendën e reformave të ardhshme të vendeve pjesëmarrëse, në këtë fushë.

Në kuadër të projektit të binjakëzimit “Mbështetje për forcimin e sistemit Shqiptar për prokurimin publik, koncesioneve dhe ankandit publik”, të Programit IPA 2008, në muajin Qershor 2011 u organizua në Varshavë, Poloni, një vizitë studimore, ku morën pjesë 4 (katër) punonjës të APP-së. Gjithashtu, në muajin Nëntor 2011, u organizua, nëpërmjet projektit të lartpërmendur, një tjetër vizitë studimore në Lisbon, Portugali, ku morën pjesë 5 (pesë) përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në vizitat studimore të sipërcituara u organizuan disa takime me përfaqësues të Agjencive të Prokurimeve të këtyre vendeve, gjatë të cilave u diskutua mbi organizimin dhe funksionimin e sistemeve respektive të prokurimit, dhe u shkëmbyen eksperiencat në këtë fushë.

9.4. Gjëndja financiare e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2010

Agjencia Prokurimit Publik në zbatim të ligjit nr.10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, ka marrë fonde nga buxheti i shtetit, si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Plani Fillestar	Ndyshimet	Plani Përfund.	Fakti	%
1.	Të ardhurat nga buxheti	59 557	-4 262	55 295	48 917	88.46 %
	Totali				48 917	

Në buxhetin e miratuar për vitin 2011, APP-së i janë parashikuar në zërin 602 “Mallra e shërbime”, 20 400 000 lekë, dhe në zbatim të ligjit nr. 10450, datë 14.07.2011, në planin e buxhetit të shpenzimeve korente për vitin 2011, për

institucionin tonë u bë paksimi i fondeve në vlerën 2 362 000 lekë.

Shpenzimet e përgjithshme të APP-së, në fund të vitit 2011, janë realizuar në masën 88.46 përqind, ose rreth 6 378 000 lekë më pak se plani.

Krahasuar me planin vjetor të realizuar, të së njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 1 280 000 lekë më pak ose rreth 24.5 përqind më të ulta.

Në totalin e shpenzimeve buxhetore të realizuara, gjatë vitit 2011, shpenzimet korente zenë rreth 72.62 përqind, nga rreth 72.55 përqind të parashikuara, ndërkohë që shpenzimet për investime zenë rreth 27.4 përqind nga 27.3 përqind të parashikuara.

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve korente, situata e realizimit të tyre në fund të vitit 2011, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

	Emërtimi	Plan 2011	Fakt 2011	Në %
1	Shpenzime paga	16 700	15 862	94.98
2	Sigurime Shoqërore	2 900	2 408	83.00
3	Mallra Shërbime	18 038	14786	81.97
4	Transferta List pritje	2 480	2 468	99.51
5	Shpenzime për nvestime	15 177	13 392	88.23
	Totali i shpenzimeve	55 295	48 917	88.46

Brenda shpenzimeve korente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 44.65 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë vitit 2011, rezultojnë me një mosrealizim prej rreth 838 000 lekë, ose rreth 94.98 përqind me parashikimin vjetor. Mosrealizimi i fondit të pagave për këtë shumë është mosdhënja e shpërblimit të fund vitit i llogaritur 5% mbi fondin e planifikuar të pagave. Fondi i pagave i planifikuar për punonjësit në listë pritje të dalë nga ristrukturimi më 01 Maj

2010 përfundoi më 31 Dhjetor 2011, me përfundimin e periudhës së pagesës.

Shpenzimet kapitale, janë realizuar 88.23 përqind. Fondi i akorduar nga buxheti në fillim të vitit ishte 15 177 000 lekë.

Detyrimet ndaj të tretëve janë shlyer rregullisht, dhe nuk ka detyrime të pashlyera për vitin 2011.

10. MARRËDHËNIET E APP-SË ME TË TRETËT

Gjatë vitit 2011, përveç komunikimeve shkresore, nëpunësit e APP-së, u kanë dhënë shpjegime dhe këshilla përfaqësuesve të institucioneve dhe në takime të zhvilluara në ambjentet e APP-së. Gjatë këtij viti, nëpunësit e APP-së kanë pritur në takime përfaqësues të Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë. Këto takime janë zhvilluar me Drejtorin e Përgjithshëm si dhe me përfaqësues të Drejtorisë Juridike, të Monitorimit dhe Publikimit dhe të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.

11. PËRMBYLLJE

Nga të gjitha të dhënat e pasqyruara në këtë analizë të punës një vjeçare të Agjencisë së Prokurimit Publik, vihet re se kontributi i kësaj të fundit ka qënë shumë i rëndësishëm dhe ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi dhe prokurimit elektronik në veçanti.

Megjithë numrin relativisht të vogël të stafit, krahasuar me detyrat që ky institucion ka në bazë të legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të konçesioneve dhe legjislacionit të ankandit publik, rezultatet e arritura gjatë vitit 2011, janë shumë pozitive, gjë që mund të shihet dhe nga të dhënat e pasqyruara në këtë analizë.

Ndër treguesit më të mirë të rezultateve të punës së APP-së gjatë vitit 2011 si dhe të përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi, e arritur kjo kryesisht për shkak të prokurimit me mjete elektronike, është përqindja e fondit të

kursyer gjatë këtij vitit, e cila është 18.6% e fondit që ka qënë në dispozicion për procedurat e prokurimit në shkallë vendi. Po kështu dhe mesatarja prej 6 ofertues për një procedurë, është një tjetër tregues i nivelit të konkurrencës në prokurimin publik.

Megjithatë puna për mirëmbajtjen e sistemit dhe administrimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme për aplikimin e një sistemi të tillë nga Autoritetet Kontraktore si dhe përmirësimin e tij të vazhdueshëm, është ende një sfidë me të cilën APP-ja do të vazhdojë të përballlet dhe gjatë vitit 2012.

Përpjekjet e APP-së për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, janë vlerësuar gjithashtu dhe nga Progres Raporti i Komisionit Evropian për fushën e prokurimit publik, edhe pse po nga ky Raport evidentohen burimet e kufizuara njerëzore të APP-së për të përmbushur të gjitha detyrat e saj ligjore. Raporti e vë theksin dhe tek mekanizmi i paqartë i monitorimit të procedurave të prokurimit publik dhe nevoja e përafrimit të mëtejshëm e legjislacionit të prokurimit në disa pika specifike, me Direktivat përkatëse të BE-së.

Gjithashtu, Raporti ka evidentuar nevojën e përmirësimeve të tjera në fushë, sidomos në drejtim të përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit të koncesioneve, prokurimeve në fushën e mbrojtjes si dhe mekanizmit të ankimit. Sipas raportit në fjalë duhet të sigurohen kapacitete të mjaftueshme në të gjitha institucionet e prokurimit publik si dhe të përcaktohen qartë dhe të ndahen përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkëpunimit midis këtyre institucioneve.

Megjithë progresin dhe arritjet e bëra gjatë vitit 2011, për realizimin e detyrave dhe përmbushjen e mëtejshme të angazhimeve të ndërmarra në fushën e prokurimit publik, pasur në konsideratë dhe ato të nxjerra nga Progres Raporti i BE_së, APP -ja ka një sërë prioritesh, për të cilat duhet të punojë në vazhdim. Ndër to si më kryesoret theksojmë,

- ⇒ Amendimi i legjislacionin të prokurimit publik dhe koncesionit, për përafrimin e mëtejshëm me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian;
- ⇒ Implementimin në praktikë të rregullave të prokurimit në sektorët utilitarë si dhe zbatimin e Marrëveshjes Kuadër nga disa prej Autoriteteve Kontraktore;
- ⇒ Përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik në:
 - Projektimin e Marrëveshjes Kuadër në sistem;
 - përmirësimin e arkivës elektronike;
 - realizimin shpalljes së dokumentave dhe hapjes së ofertave në formë elektronike, për procedurat konkurruese të koncesioneve;
 - projektimin i ankandit elektronik si fazë e fundit për procedurat e prokurimit;
- ⇒ Forcimi i kapaciteteve administrative të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit, e cila është një sfidë që ngelet gjithmonë e hapur, duke qënë se legjislacioni i prokurimit është në proces të vazhdueshëm ndryshimi. Ngritja e kapaciteteve administrative është një sfidë shumë e rëndësishme me të cilën APP-ja do të përballohet gjatë vitit 2012, në kuadër të ndryshimeve legjislative dhe përmirësimeve të disa funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik që synohen të realizohen gjatë këtij viti.